



UNIVERSITETI BUJQESOR I TIRANES
FAKULTETI I BUJQESISE DHE MJEDISIT
DEPARTAMENTI I AGROMJEDISIT DHE EKOLOGJISE

Tiranë, më 30. 03. 2017

**Udhëzim për zhvillimin e
praktikës profesionale**

për studentët që diplomohen
në programet Bachelor dhe Master Profesional
të ofruar nga Departamenti i Agromjedisit dhe Ekologjisë

PËRGJEGJËSI I DEPARTAMENTIT

Prof. Dr. Seit SHALLARI

1. Kriteria të përgjithshme

- Praktika profesionale është pjesë e programit mësimor dhe vlerësohet me notë dhe kredite. Qëllimi është të ofrojë për studentët njohje dhe shprehje praktike në një organizatë publike ose private në të cilën trajtohen aspekte mjedisore.
- Për studentët e programit bachelor praktika është programuar të zhvillohet gjatë semestrit të dytë javët 11-15. Për studentët e programeve Master Profesional praktika do të zhvillohet mbas mbarimit të provimeve të programuara në vitin e dytë.
- Praktika do të zhvillohet në një Ent ose Agjenci publike ose në një kompani private që zhvillon veprimtari me Lejë Mjedisore të Tipit A ose të çertifikuara me standartet ISO 9000 dhe ISO 14000.
- Bashkitë, Njesite Administrative Bashkiake, Prefekturat, Qarqet, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia e Zonave të Mbrojtura, Drejtoritë Rajonale të Mjedisit janë disa nga institucionet dhe agjencitë shtetërore ku mund të zhvillohet praktika profesionale.
- Në këto Ente shtetërore zhvillohen politika mjedisore në përputhje me përgjegjësitë ligjore rast pas rasti.

2. Procedura dhe udhëzime

- Studentët duhet të kontaktojnë dhe të sigurojnë pranimin për periudhën sipas programit mësimor. Fakulteti i duhet të ofrojë një dokument që siguron identitetin dhe rekomandon studentin për praktikë profesionale.
- Në momentin që studentët kanë siguruar në parim vëndin ku do të zhvillojnë praktikën bëjnë regjistrimin në departament dhe ju caktohet një pedagog në rolin e supervizorit.
- Pranë departamentit ngrihen komsione me perfaqesues nga Grupet Mesimore për të vlerësuar studentet dhe përbëhen nga 3 persona.
- Raporti i stazhit do të zhvillohet rreth një teme të dakortësuar me entin pritës dhe pedagogun që mbikqyr studentin.

Disa nga temat mund të jenë:

- Vlerësim i efikasitetit të politikave mjedisore (për kompanitë e çertifikuara me ISO)
- Vlerësimi i gjendjes mjedisore dhe zbatimi i ligjshmërisë nga kompania....
- Planet e Veprimit Mjedisor për Bashkinë ose Zonën....(vlerësimi i situatës mjedisore, evidentimi dhe adresimi i problemeve...)
- Raporti duhet të strukturohet në jo më pak se 20 faqe dhe jo më shumë se 40 faqe A4 sipas si më poshtë:
 - Kapaku
 - Dokumenti i konfirmimit për kryerjen e praktikës nga Enti pritës
 - Faqa zyrtare
 - Përmbajtja
 - Lista e tabelave, figurave, shtojcave
 - Hyrje

- Kapitulli i parë: *Vështrim bibliografik; qëllimi dhe objektivat e praktikës profesionale*
- Kapitulli i dytë: *“Emërtimi..... Emrat e kapitujve nuk janë strikte, pasi në varësi të temës mund të ketë strukturime të ndryshme”*
- Kapitulli i tretë: *“Emërtimi.....”*
- Referenca

3. Formati i raportit

- Raporti duhet të paraqitet në format libri. Kapaku duhet të jetë si në figurën më poshtë. Faqa pas kapakut është është në faqen pas kapakut.





Agricultural University of Tirana

UNIVERSITETI BUJQESOR I TIRANES

FAKULTETI I BUJQESISE DHE MJEDISIT

DEPARTAMENTI I AGROMJEDISIT DHE EKOLOGJISE

Raport

për praktikën profesionale pranë

“.....”

Programi i studimit

“Master Profesional “Menaxhim Mjedisi”

Tema:

“Tema e përzgjedhur për tu zhvilluar”

Punoi

Emër Mbiemër

Pranoi

Grada. Emër Mbiemër

Tiranë, 2017

4. Rregullat e shkrimit të raportit

Faqe A4, shkrimi duhet të jetë Times New Roman 13, Line Space duhet të jetë 1.5; margins duhet të jenë: Top, Bottom, Left, Right 1”.

Titujt duhet të jenë Times New Roman 14 bold për Headind 1, Times New Roman 13 bold për Headind 2; Times New Roman 12 bold për Headind 3.

Një shkurtim ose akronim (emër i shkurtër) përdoret vetëm në rastet kur shprehja e plotë është shumë e gjatë ose shkurtimi është i njohur në fushën e kërkimit. Edhe në këto raste duhet të përdoret një formë e shkurtër e thjeshtë për tu kuptuar. Nëse do të përdoret një shkurtim atëherë kur të përdoret për herë të parë duhet të vendoset midis kllapave pas përcaktimit të parë të shprehjes së plotë.

Tabelat duhet të numërohen në mënyrë progresive me numra arab në krye si më poshtë:

Tabela 1. Te dhënat për përmbajtjen e metaleve në tokë

Nr	Emertimi	Përmbajtja në tokë mg/kg LTH		
		A	B	C
1	Cd	A	B	C
2	Co	W	C	D
3	Cr	W	Q	L

Tabelat duhet të krijohen në word Times New Roman 11.5.

Figurat ose grafikët duhet të numërohen në mënyrë progresive në fund me numra arab si më poshtë:




Figura 1. Paraqitje e marrdhenieve midis faktoreve.....

5. Mbrojtja dhe vlerësimi

Raporti duhet të firmoset dhe vlerësohet nga pedagogu që mbikqyr studentin. Rezultatet pasqyrohen në dokumentacionin e vlerësimit të studentit.